



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:247571

Datë: 12.12.2023

Numri i dokumentit: 05049910

P.nr.1010/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal, e përbërë nga gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska, në çështjen penale kundër të pandehurës N. G. me vendbanim në Pejë, rr:"B. K.", për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2234/2023 të datës 14.11.2023, jashtë seancës, me datë 11.12.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

Kundër të akuzuarës:

N. G. , e lindur me datë, në Pejë ku edhe tani jeton në rr:" B. K.", e martuar, e gjendjes së mesme ekonomike, e identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër, e nacionalitetit shqiptar, Shtetase i Republikës së Kosovës.

- Hedhet aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë, PP.II.nr.2234/2023 të datës 14.11.2023 dhe Pushon procedura penale për shkak të veprës penale për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, *për shkak se lënda është kryer në procedurën e ndërmjetësimit.*
- Shpenzimet e kësaj procedure bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm ka parashtruar aktakuzën, PP.II.nr.2234/2023 të datës 14.11.2023, kundër të pandehurës N. G. me vendbanim në Pejë, rr:"B. K.", për shkak të veprës penale për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata me datë 27.11.2023, e ka referuar të njëjtën në procedurën e ndërmjetësimit, nga e cila procedurë palët kanë arritur marrëveshjen e datës 01.12.2023.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 453 të KPPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 229 par.5 dhe nenin 453 par.1 nënpar.4 të KPPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.1010/23, më datë 11.12.2023

Gjyqtari i vetëm gjykues
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij
Aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat
prej 3 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë,
nëpërmes kësaj Gjykate.